



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-15256

Dt.13.09.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesëve: **Rifat (Hys) Mangjukiq dhe Shpresa Mangjukiq** nga Gjakova, për dhënien e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të banimit individual, në kompleksin "Çarshija e Madhe" - Gjakovë, me etazhitet P+1+NK, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit për Planifikimin Hapësinor nr. 04.L-174, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET; aplikuesëve: Rifat (Hys) Mangjukiq dhe Shpresa Mangjukiq nga Gjakova, ndërtimi i objektit të banimit individual, në kompleksin e "Çarshisë së Madhe" – Gjakovë, sipas Projektit Kryesor të prezentuar, të aprovuar nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Gjakovë dhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës sipas Vendimit Nr. 32/2017, datë 08.05.2017, Kushteve Ndërtimore me nr. 27/2017, dt. 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1629/1, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të të lartë përmendurve, e cila shtrihet në zonën e mbrojtur të trashëgimisë kulturore, përgjatë rrugës "Sefedin Xërxa", me etazhitet të objektit P+1+NK dhe me sipërfaqe të përgjithshme të objektit prej $S = 197.18 \text{ m}^2$

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S = 7.18 \text{ m}^2$
Kati i parë: (Sip,Bruto): $S = 95.00 \text{ m}^2$
Nënkulmi: (Sip,Bruto): $S = 95.00 \text{ m}^2$

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është:

- Vendimi me Nr. 32/2017 i datës 08.05.2017, mbi aprovimin e rekomandimit nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore "Miratimi i kërkesës/ projektit për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale me numër 1629/1, ZK: Gjakovë-Qytet, nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, si dhe Kushteve Ndërtimore me nr. 27/2017, dt. 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK - Gjakovë;

- Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës rregullative dhe asaj ndërtimore e përshkruar në situacionin grafik i vërtetuar nga QRTK - Gjakovë, i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

III . Hartimin e projektit për ndërtimin e objektit të banimit individual nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për shërbime të inxhinieringut projektimit dhe ndërtimit "HARP" - Gjakovë.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit, QRTK-Gjakovë, dhe pëlqimit nga kjo drejtori të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ta lajmërojë Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të fiksimit dhe piketimit të shtrirjes së objektit mbrenda lokacionit nga Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë (të prezentohet procesverbali i inspektorëve);
- Të lejohen inspektorët e ndërtimit të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në qdo kohë pas kryerjes të ndërtimit të objektit për të cilën është dhënë leja e ndërtimit se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit dhe kushteve tekniko - urbanistike të dhëna nga QRTK;



V. Kjo leje ndërtimi vlenë 1 (një) vite, nga dita e lëshimit.

Arsyetim

Mirsad Manxhuka nga Gjakova, me banim në rrugën "Sefedin Xërxa" Nr.44, në cilësinë e të Autorizuarit sipas Aktit Notarial – Deklaratë, me nr. LRP.nr.798/2017, dt.23.02.2017, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 17/351/01-15256, të datës 16.06.2017, për ndërtimin e objektit të banimit individual, në parcelën ndërtimore me nr. 1629/1, ZK: Gjakovë - Qytet, e cila përfshihet në kompleksin e "Çarshisë së Madhe" në Gjakovë, me etazhitet të objektit +1+NK, siq është parashtruar dhe në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke pasur parasysh lokacionin e objektit i cili përfshihet në zonën me destinim të veçantë "Çarshia e Madhe" në Gjakovë, e cila është zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore, lënda i është përcjellur Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë - IMMK – Gjakovë, rrespektivisht Komisionit për Trashëgimi Kulturore, pranë Institutit të Kosoves për Trashëgimi Kulturore për dhënien e Pëlqimit në lokacion, për procedim të mëtutjeshëm dhe bazuar në Vendimin me Nr. 32/2017 i datës 08.05.2017, mbi aprovimin e rekomandimit nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore "Miratimi i kërkesës/ projektit për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale me numër 1629/1, ZK: Gjakovë-Qytet, nga M.K.R.S. e R.K.S, si dhe Kushteve Ndërtimore me nr. 27/2017, dt. 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK – Gjakovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka paraqitë edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 28.01.2016, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë
2. Kopjen e planit të datës 24.01.2017 me pronar Rifat (Hys) Mangjukiq dhe Shpresa Mangjukiq (e lindur Fazlija, gruaja e Rifatit) nga Gjakova me nga ½(pjesë ideale të pronës), të lëshuar nga D.K.GJ.P.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 278/17, të datës 24.01.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi. dhe Pronë.
4. Vendimin Nr. 32/2017, të datës 08.05.2017, për "Miratimi i kërkesës/ projektit për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim në ngastrën kadastrale me numër 1629/1, ZK: Gjakovë-Qytet, nga MKRS-RKS.
5. Kushtet Ndërtimore me nr. 27/2017, dt. 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK – Gjakovë.
6. Deklaratat Noteriale me nr. LRP.nr.2199/2017, dt.16.05.2017, dhe LRP.nr.798/2017,dt.23.02.2017.
7. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi ne prone me nr.430-L-249, dt.12.09.2017.
8. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr. 1272 të datës 17.07.2017.
9. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, me nr. 2062, dt. 06.07.2017.
10. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, të datës 04.07.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në TEB-Sh.A., filiali Gjakovë me datë 07.09.2017.
12. Projektin kryesor (3 kopje) punuar nga ndërmarrja për shërbime të inxhinieringut projektimit dhe ndërtimit "HARP" - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 925.38 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke e llogaritur ditën a marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspeksionit,
- Arkivit.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenet Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori,

Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark


K.K. GJAKOVË
Z.k.Gjakove Qytet
Parcela:1629-1

PLAN SITUACIONI

Matjet jane kryer me gps kopos dhe total station


Kos-Reef

Veriu



Legjenda:

	Gjendja kadastrale
	Gjendja faktike
	Puset kanalizimi
	Shtylle elektrike
	Puset atmosferiku
	Puset Ujshelisi



28. Janar. 2016
Auto Cad 2012

P = 1 : 500

Punoi : N.SH. Matijeve
"Geo Station"
Gjako






Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m ²
P - 70705029 - 01629 - 1	Parcelë \ Parcela \ Parcel -shtëpi	44.0
	Parcelë \ Parcela \ Parcel -oborr	387.0



Rrugë 9146-0

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 24.01.2017
Koha \ Vreme \ Time : 15:16:17
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature :
Shënim \ Beleška \ Note :

Aprovoi \ Usvojio \ Approved : Drejtori \ Direktor \ Director

Nënshkrimi \ Potpis \ Signature :

